

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË
TINA Fashion SHPK**

THEMELIMI

NENI 1 - ORTAKËT THEMELUES

1.1 Shoqëria TINA Fashion SHPK themelohet nga Ortaku i Vetëm:

Z. Kreshnik Kapxhiu shtetas shqiptar, lindur më 23-06-1982 në Çorovodë, Skrapar, banues në Rruga "Marie Kraja", Ndërtesa 8, H. 15, Ap. 8, Kashar, Yzberisht, Tiranë, mbajtës i Nr. Personal I20623200R, me zotësi të plotë për të vepruar;

I cili me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë krijon shoqërinë si vijon.

EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE

NENI 2 – EMËRTIMI

2.1 Emërtimi i shoqërisë është **TINA Fashion SHPK** (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

NENI 3 - FORMA LIGJORE

- 3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.
- 3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 4 - BAZA LIGJORE

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Akt Themelimi dhe Statut, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore në fuqi.
- 4.2 Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut, do të aplikohen dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
- 4.3 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me zbatimin dhe/ose interpretimin e këtij Statuti, do të zgjidhet nga gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 5 - PERSONALITETI JURIDIK. KOHËZGJATJA

- 5.1 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në Tiranë, Shqipëri.
- 5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë është i pakufizuar.

NENI 6 – SELIA

- 6.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga "Marie Kraja", Ndërtesa 8, H. 15, Z.K. 3806, nr. Pasurie 216/191 n. 15, Vol. 60, Fq. 196, Kashar, Yzberisht, Tiranë.
- 6.2 Shoqëria mund të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj.

- 6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera Shqiptare ose të huaja që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

NENI 7 - EMBLEMA. VULA

- 7.1 Shoqëria do të ketë emblemen dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë.
- 7.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar.
- 7.3 Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përmbajnë emblemen dhe vulën e saj.

NENI 8 – OBJEKTI

- 8.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:
- Qëndistari, punime lëkure me dorë, çanta, këpucë, rripa, aksesore të ndryshëm.
- 8.2 Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër i cili është në përputhje me Ligjet e Republikës së Shqipërisë.

NENI 9 – KAPITALI THEMELTAR

- 9.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100(njëqind) LEKE.
- 9.2 Kapitali themeltar përbehet nga 1 (nje) kuotë me vlerë nominale 100(njëqind) LEKE.
- 9.3 Kapitali zotërohet tërësisht nga Ortaku i Vetëm.
- 9.4 Përgjegjësia e Ortakut shtrihet deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin e Shoqërisë.

NENI 10 - TRANSFERIMI I KUOTAVE. KUFIZIMET

- 10.1 Kuota e kapitalit është e transferueshme dhe mund të transferohet në çdo moment sipas kushteve dhe afateve të parashikuara nga ligji shqiptar.
- 10.2 Vendosja e çfarëdolloj barre mbi pjesët e kapitalit në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e Asamblesë së Ortakëve.

ORGANET E SHOQËRISË

NENI 11 - VENDIMET E ASAMBLESE SË ORTAKËVE

- 11.1 Asambleja e Ortakëve në përputhje me legjislacionin shqiptar, mund të vendosë, por pa u kufizuar në to, vendimet me poshtë:
- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre nga administratori ose administratorët, përfshi raportet financiare;
 - zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - miratimin e shkrirjes/bashkimit me shoqëri të tjera;
 - ndryshimin e statutit të shoqërisë;
 - ndryshimin e selisë dhe të emërimit të shoqërisë;
 - emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar, në qoftë se është e nevojshme;
 - rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
 - shitjen ose transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar palëve të treta;
 - ristrukturimin dhe prishjen shoqërisë;
 - emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë;
 - miratimin e pasqyrave financiare të shoqërisë dhe raportit të administratorit(ëve);

- vendimin për shpërndarjen e fitimit dhe mbulimin e humbjeve;
- transformimin e shoqërisë në formë të tjera;
- dhe çdo lëndë tjetër të parashikuar nga Statuti ose nga ligji.

NENI 12 – ADMINISTRIMI

- 12.1 Administrimi i shoqërisë do të kryhet nga një ose më shumë administratorë që emërohen me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Në rast se Shoqëria do të administrohet nga më shumë se një administrator, atëherë Administratorët mund t'i ushtrojnë kompetencat bashkërisht ose veçmas sikurse do të përcaktohet në vendimin përkatës të Asamblesë së Ortakëve.

- 12.2 Administratori i parë i shoqërisë është:

Z. Xhemal Burreli shtetas shqiptar, lindur më 28/02/1959 në Laknas, banues në Laknas, Kamëz, Tiranë, Rruga "Nënë Tereza", Banesa nr. 3, me Nr. Personal F90228242P.

- 12.3 Administratorëve u jepen të gjitha kompetencat e përcaktuara nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në to, Administratorët janë përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:
- drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
 - përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët personalisht ose me përfaqësim;
 - hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit;
 - përgatitjen e dokumenteve në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zotëron;
 - të lidhë kontrata për dhe në emër të shoqërisë me palë të treta, të punësojë dhe pushojë punëmarrës apo staf tjetër që konsiderohet i nevojshëm për mbarrëvajtjen e aktivitetit të shoqërisë;
 - të përfaqësojë shoqërinë përpara bankave të nivelit të dytë dhe Bankës së Shqipërisë si dhe të kryejë çdo transaksion bankar në emër të shoqërisë;
 - të ndërmarrë çdo veprimtari tjetër, ose biznes, ose aktivitet i cili konsiderohet i nevojshëm për administrimin efikas të Shoqërisë në Shqipëri.
- 12.4 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm për pesë vjet me të drejtë ripërtëritje ose deri në çastin e revokimit të tij me vendim të Asamblesë së Ortakëve.
- 12.5 Administratori i Shoqërisë mund t'i transferojë çdo personi apo grupi personash të gjitha apo një pjesë të kompetencave të tij sipas këtij Statuti dhe me kushtet që ai konsideron si të arsyeshme dhe në çdo kohë mund të anultojë këtë transferim kompetencash.

NENI 13 - VITI FINANCIAR

- 13.1 Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti.
- 13.2 Përgjashtimisht, viti i parë financiar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

NENI 14 - BILANCI. KONTABILITETI.

- 14.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatimore dhe Qendrës Kombëtare të Regjistrimit deri në fund të muajit Mars të çdo viti pasardhës.
- 14.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkesave të legjislacionit përkatës. Për operacione të veçanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të veçanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit.

- 14.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 15 - TE ARDHURAT, DIVIDENDI

- 15.1 Shoqëria mund të krijojë fonde rezerve për realizimin e qëllimeve të aktivitetit të saj në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 15.2 Fitimet që do të rezultojnë në fund të mbylljes së çdo viti ushtrimor, pas pagimit të tatimeve, mund të ndahen nga Asambleja e Ortakëve.
- 15.3 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe çdo ortak do të përgjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

NENI 16 – LIKUIDIMI

- 16.1 Likuidimi i Shoqërisë si dhe emërimi i likuidatorit(eve) bëhet në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe çdo ligj tjetër të zbatueshëm.

NENI 17 – MOSMARRËVESHJET


- 17.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

NENI 18 - KLAUZOLË MBYLLËSE

- 18.1 Ky Statut hartohet në 3 (tre) ekzemplare me fuqi të njëjtë ligjore.

ORTAKU I VETËM

Z. KRESHNIK KAPXHIU



Data 18/11/2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER MAJLINDA DEMOLLARI

DATE 18/11/2020
NR REP 9832



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot me date 18.11.2020 (dymije e njezet) vertetoj nenshkrimin e ortakut te vetem te Shoqerise "TINA Fashion" shpk, perfaqesuar nga **Z. Kreshnik Kapxhiu**, i datelindjes 23.06.1982 ,lindur ne Corovode, Skrapar madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin me numer I20623200R, i cili deklaroi se Akti i Themelimit dhe Statuti eshte nenshkruar prej tij jashte kesaj zyre noteriale dhe une noterja **Majlinda E. Demollari** vertetoj nenshkrimin e tij sipas ligjit.

NOTER
MAJLINDA DEMOLLARI

NOTE
Majlinda E. Demollari
NIP: K41606040
Tel: 0682061560